



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2013

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mars 2014

Telefon: 038 245 031
Telefaks: 038 245 034
Web faqja: www.kpm-ks.org
E-mail: info@kpm-ks.org

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
BAZA LIGJORE	7
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE	7
Përbërja	7
AKTIVITETET E KPM-SË	8
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	9
PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE	11
Personeli.....	11
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)	11
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore	11
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale	12
Televizioni Publik i Kosovës – RTK1	12
Televizionet nacionale: TV21 dhe KTV	12
Televizionet regjionale, lokale dhe OSHP-të.....	13
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit	13
Monitorimi i Pajtushmërisë së Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së	13
Monitorimi i të licencuarve për mbulimin e Zgjedhjeve Lokale 2013	13
Ankesat nga publiku	14
Vizitat/ Monitorimet në terren	14
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT	14
Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës në vitin 2013.....	15
Subjekte transmetuese.....	15
Operatorë Kabllorë:	15
Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP).....	15
Shqyrtimi i kërkesave	16
DEPARTAMENTI LIGJOR.....	17
Rastet për transmetim ilegal.....	17
Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KKPM 2009/04;	17
Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01	18
Rastet për shkelje të Rregullores për të Drejtën e Autorit	18

Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës	18
Pjesa 3 e Licencës (Formati i Programit).....	18
Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01.....	18
Rastet e Shkeljes së Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM 2010/01.	19
Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, neni 2.1.3, dhe 2.1.5 dhe neni 18.3 dhe neni 18.4, të Rregullores për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04.....	19
Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së neni 28 – Mos sjellja e raportit vjetor	19
Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së, Neni 22 paragrafi 3.1.....	20
Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 49, paragrafi 7, dhe Neni 48.....	20
Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2013	21
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR	21
Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge.....	21
Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....	22
Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)	22
Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal	23
Rastet për interferencë	23
Rastet për transmetime të palicencuara.....	23
Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR.	23
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE.....	24
Buxheti.....	24
BORDI I ANKESAVE	25
Seancat e Bordit të Ankesave dhe Vendimet.....	25
REALIZIMI I OBJEKTIVAVE PËR VITIN 2013	27
ZHVILLIMI I POLITIKËS SË TRANSMETIMIT	27
PËRCJELLJA E PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT NË TËRË KOMPLEKSITETIN E VET	27
ZHVILLIMI I PLURALIZMIT MEDIAL QË U SHËRBEU GJITHË QYTETARËVE TË KOSOVËS	28
MBULUESHMËRIA E ZONAVE TË VEÇANTA GJEOGRAFIKE TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (rrugëve magjistrale dhe regjionale) ME SINJAL KUALITATIV TË PROGRAMEVE TE RADIO PROGRAMEVE ME MBULUESHMËRI NACIONALE	29

KRIJIMI I KUSHTEVE PËR ARKIVIMIN AFATGJATË TË PROGRAMEVE TË MONITORUARA (afati ligjor 7 vite)	29
AVANSIMI I BASHKËPUNIMIT ME AUTORITETET RREGULLATIVE EVROPIANE: 29 OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014.....	30

SHTOJCAT

Shtojca I	Organogrami
Shtojca II	Raporti –Monitorimi i Shënimeve mediale audio-vizuale për Zgjedhjet Lokale 2013
Shtojca III	Paraqitja tabelare e Rasteve Ligjore
Shtojcën IV	Raporti Vjetor Financiar
Shtojca V	Raportet e hulumtimeve
Shtojca Va	Vlerësimi i gatishmërisë së qytetarëve për kalimin në transmetimin digjital
Shtojca Vb	Analiza e tregut të reklamës në Kosovë

PARATHËNIE

Në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave ju përcjellim raportin e aktiviteteve të Komisionit të Pavarur të Mediave (tani e tutje Komisioni), për periudhën kohore janar-dhjetor 2013.

Komisioni në përbërje jo të plotë, së bashku me Zyrën Ekzekutive, vazhdoi punën për të realizuar objektivat institucionale të caktuara më parë. Prioritet ishte angazhimi për plotësim ndryshimin e Draft Strategjisë për transmetimin digjital tokësorë për ta përcjellur pastaj në Qeverinë e Republikës së Kosovës për miratim. Me Ligjin e KPM-së është paraparë që të ketë edhe Ligj për digjitalizim i cili duhet të bazohet në strategjinë e KPM-së. Ky ligj është hartuar nga Ministria për Zhvillim Ekonomik, ku pjesë e grupit punues ishte edhe KPM.

Nga Ligji i ri për KPM-në kanë rrjedhur disa obligime që të rishikohet baza ligjore sekondare dhe për ta realizuar këtë KPM-ja gjatë vitit 2013 ka punuar në amandamentimin e rregulloreve të saj, të cilat janë dërguar edhe për dëgjim publik tek të licencuarit e KPM-së. Në muajin maj të vitit 2013 janë miratuar disa rregullore kurse të tjerat janë vënë në konsultime publike. Të gjitha këto akte nënligjore kanë mbetur të miratohen gjatë vitit 2014.

Gjatë vitit 2013, KPM-ja ka vlerësuar pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me të gjitha rregulloret e Komisionit të Pavarur të Mediave, në veçanti ka vlerësuar pajtueshmërinë e me Ligjin për Zgjedhjet në Republikën e Kosovës për zbatimin e kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Vlerësimi i pajtueshmërisë është bërë përmes monitorimeve të rregullta dhe të kategorizuara sipas akteve nënligjore.

Tjetër shqetësim vazhdon të mbetet, në të shumtën e rasteve, mos kategorizimi i duhur i përmbajtjeve programore, mosrespektimi i kohës për transmetim të programeve, si dhe mos sinjalizimi dhe njoftimi paraprak për përmbajtjet e dëmshme programore. Monitorime janë bërë edhe për komunikimet komerciale, kodin e sjelljes dhe të drejtën e autorit. Për secilën shkelje të evidentuar, janë ndërtuar raste sipas rregullave të procedurës në pajtim me Ligjin e KPM-së. Për shkelje më të rënda dhe për të cilat nuk është arritur pajtueshmëri pavarësisht veprimeve të KPM-së, janë aplikuar sanksione. Krahas monitorimeve, janë hapur raste ligjore ex officio por edhe të inicuar nga ankesat e publikut.

Në KPM janë të licencuar 21 TV Stacione, 83 Radio Stacione, 32 Operatorë Kabllorë dhe 53 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP).

Si pasojë e shkeljeve ligjore që rezultuan me shkarkimin e kryetarit dhe një anëtareje të Komisionit të KPM-së si dhe dorëheqjes së një anëtari dhe shuarjes së mandatit të një anëtari tjetër, Komisioni në fund të dhjetorit 2013 ka mbetur pa kuorum dhe në pamundësi që të finalizojë në tërësi objektivat e planifikuara.

Për vitin 2014, Komisioni i KPM-së synon që të realizojë objektivat e rëndësishme si për zhvillimin e politikës audiovizive poashtu edhe për vet institucionin e KPM-së. Prioritet parësor mbetet finalizimi i Strategjisë për kalimin e transmetimeve analoge tokësore në atë digjitale tokësore, amandamentimi i akteve nënligjore si dhe krijimi i politikave për procesin e digjitalizimit; koordinimi me shtetet fqinje i planit frekuencor digjital (me qëllim që të mos ketë interferime në brezin frekuencor me vendet fqinje); avancimi i bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane për çështje që lidhen me fushën e rregullimit të transmetimit dhe brezit frekuencor radiodifuziv, etj.

Mars 2014

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

BAZA LIGJORE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-44 për KPM-në, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe ka hyrë në fuqi me 20 prill 2012. Në bazë të këtij ligji, përkatësisht Nenit 3, KPM-ja është i vetmi autoritet rregullativ për fushën audio-vizuale, i cili harton dhe miraton politikën e transmetimit si dhe të gjitha aktet nënligjore rregullative për fushën audio-vizuale. KPM është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2.8 KPM-ja *“i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës”*.

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Përbërja

Komisioni ka filluar vitin 2013 me 5 anëtarë dhe mandej në seancën e mbajtur me 30 janar 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës nga radhët e minoritetit serb, ka emëruar Vesna Jovanović anëtarë e Komisionit të KPM-së me mandat 3 vjeçar. Në fund të vitit, dhjetor 2013, Komisioni ka mbetur pa kuorum si rezultat i një dorëheqje, dy shkarkimeve për shkak që një anëtar i Komisionit ka vdekur:

- Emrush Kastrati, anëtar i KPM-së, i emëruar me 30 gusht 2013, me mandat 3 (tre) vjeçar, më 12 shtator 2013 ka ofruar dorëheqjen nga pozita e anëtarit të KPM-së. Më 25 shtator 2013, Kryesia e Kuvendit të Kosovës në bazë të vendimit Nr. 04-P-065/k ka miratuar dorëheqjen e z. Kastrati dhe njëkohësisht nga KPM ka kërkuar të nisë procedurat për nominime të reja.
- z. Nevzat Hydaverdi Anëtar i KPM-së, i emëruar me 30 gusht 2013, me mandat 2 vjeçar, nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë, ka ndërruar jetë më 11 dhjetor 2013, me ç'rast edhe mandati i tij ka pushuar.

- Në seancën e mbajtur më 26 dhjetor 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 65 paragrafi 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në nenin 67 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 14 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, pas shqyrtimit të Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka vendosur të shkarkojë nga pozita z. Shefki Ukaj, Kryetar i Komisionit të Pavarur për Media (i emëruar më 30 gusht 2012), dhe Vesna Jovanoviq, anëtare (e emëruar më 30 janar 2013) pasi që është vërtetuar se janë në shkelje të nenit 14 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.
- Drita Begolli anëtare e KPM-së, e emëruar me 30 gusht 2013, me mandat 4 (tre) vjeçar, më 4 shkurt 2014 ka ofruar dorëheqjen nga pozita e anëtares së KPM-së. Më 11 shkurt 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar dorëheqjen e znj. Begolli dhe njëkohësisht, nga KPM ka kërkuar të nisë procedurat për nominime të reja.

Anëtari i shtatë nuk është emëruar fare gjatë vitit 2013 edhe përkundër proceseve të iniciuara nga KPM dhe të proceduara deri në votim në Kuvend:

- Më 6 shkurt 2013, KPM ka bërë shpalljen publike për nominime për një anëtar të Komisionit. Afati për nominime ka përfunduar me 20 shkurt 2013 dhe gjatë kësaj periudhe KPM ka pranuar dymbëdhjetë (12) nominime.
- Më 15 prill 2013 KPM ka bërë shpalljen publike për nominime për një anëtar të Komisionit. Afati për nominime ka përfunduar më 29 prill 2013 dhe gjatë kësaj periudhe KPM ka pranuar 14 nominime
- Më 18 qershor 2013 KPM ka bërë shpalljen publike për nominime për një anëtar të Komisionit. Afati për nominime ka përfunduar më 2 korrik 2013 dhe gjatë kësaj periudhe KPM ka pranuar 16 nominime
- Më 1 tetori 2013 KPM ka bërë shpalljen publike për nominime për dy anëtarë të Komisionit. Afati për nominime ka përfunduar më 15 tetor 2013 dhe gjatë kësaj periudhe KPM ka pranuar 20 nominime.
- Për nominimin e 5 anëtarëve të KPM-së (3 nga radhët e komunitetit shumicë shqiptare dhe dy nga radhët e komuniteteve jo shqiptare në Republikën e Kosovës) ftesa publike është bërë me 10 janar 2014 dhe afati për nominime ka përfunduar më 31 janar 2014.
- Pas procedurave të KPM-së për shpalljen e ftesës për nominime për pozitat e lira në Komision, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka pasur në agjendë çështjen e emërimit të anëtarit të shtatë më 30 janar, 4 prill, 13 qershor dhe 26 shtator 2013.
- Kurse në seancën e 12 dhjetorit 2013 në agjendë ka qenë emërimi i dy anëtarëve (anëtarit të shtatë që nuk është emëruar asnjëherë dhe për zëvendësimin e anëtarit që ka dhënë dorëheqje në muajin gusht 2013). Këto procese votimi nuk kanë rezultuar me emërim.

AKTIVITETET E KPM-SË

Në bazë të obligimeve ligjore, KPM-ja gjatë vitit 2013 ka mbajtur 44 takime të rregullta të Komisionit, në të cilat ka marrë 82 vendime të ndryshme në rastet e licencimit dhe rastet ligjore.

Gjatë vitit 2013 Komisioni ka marrë këto vendime:

- 2 Vendim për licencimin e RTK 3 dhe RTK 4 (si OSHP);
- 4 Vendime për licencimin e OSHP-ve;
- 19 vendime për licencimin e Operatorëve Kabllorë;
- 2 vendime për ndryshimin e emrit;
- 2 vendime për ndryshimin e pronësisë;
- 1 vendime për revokimin e licencës;
- 5 vendime për ndryshimin e lokacionit;
- 15 vendime - masa sanksionuese - dënim me gjobë prej 1000 euro, për 15 Shërbime mediale audio-vizuale, subjekte të licencuara nga KPM, të cilat përkundër vërejtjes me shkrim që kanë marrë vitin e kaluar prej KPM, edhe në 2013 kanë përsëritur të njëjtën shkelje të Nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, mos dorëzim i raportit vjetor financiar.
- 28 vendime - masa sanksionuese - Vërejtje me shkrim – 19 shërbime mediale audio-vizuale dhe 9 Ofrues të Shërbimeve Programore, subjekte të licencuara nga KPM, të cilat për herë të parë kanë bërë shkelje të Nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, mos dorëzim i raportit vjetor financiar
- 4 vendime masa sanksionuese – Vërejtje me shkrim, për 4 Shërbime mediale audio-vizuale dhe një Ofrues të Shërbimeve Programore, subjekte të licencuara nga KPM, të cilat kanë bërë shkelje të Kreut VIII, Nenit 48 të Ligjit për Zgjedhjet Nr.03/L-073, Udhëzuesit të KPM-së dhe Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KKPM-2010/01

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

BASHKËPUNIMI RAJONAL

Me 22 shkurt 2013, KPM është takuar me një delegacion nga Këshilli i Radio Difuzionit të Republikës së Maqedonisë. Ky takim është mbajtur me qëllim shkëmbimit të mendimeve dhe sugjerimeve mbi problemet dhe sfidat me të cilat përballen dy institucionet, e sidomos në aspektin e detyrimeve që dalin nga procesi i kalimit nga sistemi analog i transmetimeve televizive në atë Digjital. Në takim palët u dakorduan për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet KPM-së dhe Radio Difuzionit të Republikës së Maqedonisë. Delegacioni nga Shkupi ka shprehur gatishmërinë e Rregullatorit të Radio Difuzionit të Maqedonisë që me përvojën e tyre të ndihmojë Kosovën në procesin e digjitalizimit. KPM bashkë me mysafiret nga Maqedonia kanë bërë vizitë tek Radio Televizioni 21 (RTV21-televizion komerciale me frekuencë nacionale) ku janë njoftuar për se afërmi me funksionimin e këtij mediumi.

Më 28 shkurt 2013, Komisioni i KPM-së ka vizituar Agjencionin për Komunikimet Elektronike të Maqedonisë (AEK) dhe Këshillin për Radiodifuzion, me qëllim të inicimit të bashkëpunimit për koordinimin e frekuencave televizive tokësore digjitale. Së shpejti pritet të arrihet edhe Marrëveshje e Mirëkuptimit ndërmjet KPM-së dhe AEK.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi ndërkombëtar ka vazhduar përmes platformave në të cilat është e anëtarësuar KPM, në EPRA dhe MNRA, respektivisht përmes pjesëmarrjes në konferencat vjetore. Poashtu, nga 25 deri më 28 janar 2013, delegacioni i Komisionit të Pavarur të Mediave ka vizituar Rregullatorin Sekundar të Mediave Izraelite në Jerusalem. Ishte kjo një mundësi e mirë që delegacioni i KPM-së të njoftohet me punën e këtij Rregullatori dhe përvojat e tij në procesin e digjitalizimit, pasi që Izraeli tash e një vit kishte përfunduar procesin e digjitalizimit të mediave elektronike.

ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE

Duke përmbushur obligimin ligjor që del nga neni 8 i Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM me 19 shkurt 2013 ka mbajtur takimin publik me përfaqësuesit e shërbimeve mediave audio-vizuale si dhe me palët e interesuara lidhur me amandamentimin e draft rregulloreve:

- Rregullore për Komunikimet Komerciale Audio-vizuale;
- Rregullore për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale;
- Rregullore për të Drejtën e Autorit;
- Rregullore e KPM-së për Dhënien e Licencës;
- Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së;

Pjesëmarrës të takimeve publike të organizuara nga KPM ishin përfaqësues të mediave nacionale, lokale, Asociacionit të Mediave Elektronike të Kosovës (AMPEK), Operatoreve Kabllorë (OK), Ofruesve të Shërbimeve Programore (OSHP), gazetarë, UNICEF-it, OSBE-së si dhe të komunitetit të biznesit, të cilët me komentet e tyre të bazuara dhe argumentuara kanë kontribuar në plotësimin dhe ngritjen e cilësisë së akteve nënligjore të KPM-së, të cilat i shërbejnë industrisë së medieve elektronike në Republikën e Kosovës.

Më 29 maj 2013 ka realizuar konsultimin publik lidhur me DRAFT RREGULLOREN PËR VLERËSIMIN E APLIKACIONEVE PËR LICENCË TË KPM-së si dhe më 16 dhjetor 2013, KPM ka mbajtur dëgjimin publik lidhur me DRAFT RREGULLOREN PËR SHPËRNDARJEN E SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO-VIZUELE DHE SHËRBIMEVE RADIO MEDIALE PËRMES OPERATORËVE TË RRJETIT.

Këto draft rregullore janë në proces të plotësim/ndryshimit të tyre me komentet e pranuar nga përfaqësuesit e shërbimeve mediale audio-vizuale dhe palëve tjera të interesuara, të cilat pastaj do të miratohen nga Komisioni i KPM-së.

PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Viti 2013 ka filluar me Ushtrues Detyre të Kryeshefit Ekzekutiv të KPM-së, si pasojë e lirimit nga detyra e Kryeshefes Ekzekutive të KPM-së znj. Naile Selimaj-Krasniqi në bazë të vendimit V8-2012 me Nr.: 1210/914KPM/shu. Më 26 shkurt 2013 është kthyer në detyrë pasi që Gjykata ka rrëzuar vendimin e Komisionit. Me Vendimin Nr. Ref. 1302/397/KPM/sh.u, Komisioni i ka vazhduar mandatin znj. Naile Selimaj-Krasniqit edhe për 3 vite, në pozitën e Kryeshefes Ekzekutive të KPM-së. Kjo çështje është potencuar edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian ku është thënë që shumica e punës së Komisionit është penguar për shkak të vendimit të paligjshëm të tij për të larguar Kryeshefen dhe që ky vendim është rrëzuar nga Gjykata.

Personeli

Zyra Ekzekutive e KPM-së nga 1 janar deri më 31 gusht 2013, ka funksionuar me një staf prej 29 punëtorësh. Ndërkaq me 31 korrik 2013, Zyra Ekzekutive ka publikuar shpallje për rekrutim për pozitat Zyrtar për Financa dhe Zyrtar të lartë për Moniorim Regjional. E gjithë procedura është zhvilluar në gusht të vitit 2013 dhe nga 1 tetori i vitit 2013 janë rekrutuar dy zyrtarë të stafit të Zyrës së KPM- së.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë 4 departamente për Rregullimin e Transmetimit (Departamenti i Monitorimit dhe Analizës, Departamenti i Licencimit, Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Menaxhim Frekuencor) dhe Departamenti i Administratës. Në kuadër të Zyrës vepron edhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB). *Shtojca I Organogrami*

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)

Departamenti i Monitorimit dhe Analizave (DMA), gjatë vitit 2013 ka vlerësuar pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me të gjitha rregulloret e KPM-së, Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, ndërsa gjatë fushatës për Zgjedhjet Lokale 2013, ka vlerësuar pajtueshmërinë me Ligjin për Zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

Realizimi i aktiviteteve të sipërsënuara dhe rekomandimet e këtij Departamenti pas monitorimeve të bëra, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të KPM-së kanë mbështetur shumë veprime të mëtutjeshme.

Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuale me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore janë monitoruar shërbimet mediale audio-vizuele me mbulim nacional, regjional e lokal si dhe ofruesit e shërbimeve programore.

Gjetjet nga ky monitorim kanë dëshmuar se numri i shërbimeve mediale audio-vizuele të gjetura në shkelje të kësaj rregulloreje është dukshëm më i vogël krahasuar me monitorimet nga vitet e kaluara.

Megjithatë, mosrespektimi i kohës së paraparë për transmetim të kategorive të caktuara programore, mos sinjalizimi dhe mos njoftimi paraprak për përmbajtjet e dëmshme programore mbetin shkeljet më të shpeshta të identifikuar.

Gjatë monitorimeve për pajtueshmërinë me këtë rregullore në edicione të lajmeve janë identifikuar raste të transmetimit pa paralajmërim të skenave të dhunshme nga luftimet e ndryshme nëpër botë si: pamjet e kufomat pas vrasjeve e bombardimeve në Siri, skena të vuajtjeve nga pasojat e helmeve kimike apo skena nga aktet e ndryshme terroriste.

Lidhur me këto skena shqetësuese e me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve nga këto përmbajtje të dëmshme programore, KPM ka ftuar shërbimet mediale audio-vizuale që t'i paralajmërojnë skenat e dhunës dhe frikës dhe të përzgjedhin me vëmendje kohën e transmetimit të tyre.

Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale

Sasia e reklamave të transmetuara brenda një ore program, vendosja e produkteve, sponsorimet, teleshopingu, reklamimi me ekran të ndarë si dhe dispozita tjera, ishin fokus i vlerësimit të pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuele me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuele.

Televizioni Publik i Kosovës – RTK1

Përderisa Rregullorja për Komunikime Komerciale u lejon shërbyesve media audio-vizuel komercial që brenda një ore të transmetojnë 12 minuta komunikime komerciale, sipas Ligjit për RTK-në, Televizioni Publik mund të emitojë komunikime komerciale deri në dhjetë për qind (10%) të vëllimit të tërësishëm programor.

Nga tri monitorimet për vlerësimin e pajtueshmërisë me Ligjin për RTK-në dhe Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuele gjatë vitit 2013, RTK është gjetur dy herë në shkelje. Shkeljet kanë të bëjnë kryesisht me: kohëzgjatjen e teleshopingut (neni 17.2 i Ligjit për RTK-në) dhe mos paralajmërimin e komunikimeve komerciale audio-vizuale me mjete dëgjimore, pamore apo hapësinore (neni 9.1 i Rregullores për Komunikime Komerciale audio-vizuele).

Televizionet nacionale: TV21 dhe KTV

Monitorimet e TV 21 dhe KTV kanë dëshmuar se këto dy shërbime mediale audio-vizuele kanë vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuele, respektivisht me dispozitat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e komunikimeve komerciale, teleshopingun, vendosjen e produkteve dhe dallimin e reklamimit dhe teleshopingut nga përmbajtjet tjera programore me anë të mjeteve pamore dëgjimore apo hapësinore.

Televizionet regjionale, lokale dhe OSHP-të

Sipas 56 monitorimeve të bëra televizioneve regjionale e lokale dhe ofruesve të shërbimeve programore (OSHP) të përfshira në këtë projekt, në shkelje të kësaj Rregulloreje janë gjetur: TV Tema, TV liria, OSHP Klan Kosova, TV Vali, TV Mitrovica, Zico TV, On TV, dhe News TV.

Pas Njoftimeve për Shkelje, në pajtueshmëri me këtë rregullore kanë ardhur TV Vali dhe TV Mitrovica.

Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit

Realizimi i projektit lidhur me pajtueshmërinë me të drejtën e autorit, ka dëshmuar se me përjashtim të një shërbimi medial audio-vizuel, të gjitha shërbimet mediale audio vizuale kanë siguruar dhe ofruar në KPM marrëveshjet për të drejtën e autorit lidhur me programet e transmetuara.

Gjatë këtyre monitorimeve vëmendje e posaçme i është kushtuar edhe identifikimit të kanaleve që ri-transmetohen nga OK dhe posedimit të kontratave valide për ritransmetimin e tyre.

Vlerësimi i pajtueshmërisë me të drejtën e autorit është intensifikuar veçmas në periudhën e organizimit të kampionateve, ligave dhe ndeshjeve të tjera sportive gjatë vitit 2013.

Monitorimi i Pajtueshmërisë së Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së

Me qëllim të krijimit të një pasqyre më të saktë për pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuale me skemën programore, respektivisht me formatin e programit të cilin shërbimet mediale audio-vizuale e kanë deklaruar me rastin e aplikimit për licencë afatgjate, DMA ka monitoruar televizionet nacionale, regjionale/lokale dhe OSHP-të.

Në kuadër të këtij monitorimi janë incizuar, shikuar, matur dhe analizuar formatet dhe strukturat programore të programit një javorë, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga stafi monitorues. Gjithashtu, janë përpiluar tabela në të cilat pastaj janë futur të dhënat e gjetura nga monitorimi lidhur me llojin dhe tipin e programit të secilit shërbim medial audio-vizuel.

Përkundër disa ndryshimeve në formatin dhe strukturën e programit, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale në periudhën monitoruese kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së – Formatin e Programit.

Kjo, pasi që ndryshimet e bëra, në shumicën e rasteve nuk kanë tejkalluar një të katërtën e ndonjë kategorie të Tipit të Programit ose të Burimit të Programit, siç parashihet në nenet 1.0 dhe 2.1 të Pjesës 3 të Licencës së KPM-së.

Monitorimi i të licencuarve për mbulimin e Zgjedhjeve Lokale 2013

KPM është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet nga të licencuarit (shërbimet mediale audio-vizuale).

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuele me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për Mediat Gjatë Fushatës së Zgjedhjeve, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës, ka bërë monitorimin e mbulimit të Zgjedhjeve Lokale 2013.

Në monitorim janë përfshirë 24 shërbime mediale audio-vizuele, nga të cilat 3 televizionet nacionale, 17 televizione regjionale dhe lokale si dhe 4 ofrues të shërbimeve programore (OSHP).

Fokus i monitorimeve ishin edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, intervistat, debatet dhe spotet politike, në kohën e shikueshmërisë më të madhe, prej orës 17:00 deri 24:00.

Gjatë monitorimit janë bërë matjet e hapësirës së dedikuar secilit subjekt politik të certifikuar, ndërsa, mënyra e prezantimit është vlerësuar si: pozitive, negative apo neutrale.

Gjetjet nga monitorimi i performancës së mediave gjatë dy raundeve të Zgjedhjeve Lokale 2013 janë përmbledhur në raportin: *Monitorimi i shërbimeve mediale audio-vizuele gjatë fushatës për Zgjedhje Lokale – 2013 (Shtojca II Raporti- Monitorimi i Shërbimeve Mediale Audio-vizuele gjatë Fushatës për Zgjedhje Lokale – 2013)*

Ankesat nga publiku

Pajtueshmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuele është vlerësuar kryesisht me rastin e ankesave nga publiku.

Gjatë vitit 2013, në KPM janë parashtruar 28 ankesa lidhur me shkeljet e pretenduara të shërbimeve mediale audio-vizuele. Nga numri i tërësishëm i ankesave të parashtruara, 10 ankesa janë parashtruar në kohën e organizimit të Zgjedhjeve Lokale 2013 dhe kanë të bëjnë me shkelje të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të vlerësimit të bazueshmërisë së këtyre ankesave, DMA ka bërë monitorime të detajuara si dhe analiza të përmbajtjeve të apostrofuara, pas të cilave ka bërë rekomandime tek departamentet tjera.

Vizitat/ Monitorimet në terren

Me qëllim të identifikimit të operatorëve kabllorë të cilët veprojnë ilegalisht, zyrtarë të DMA- së kanë bërë vizita e inspektime në tërë Kosovën. Gjatë vizitave, zyrtarë të DMA-së kanë identifikuar operatorë kabllor ilegal, të cilët janë urdhëruar të ndërpresin operimin ilegal dhe janë udhëzuar që të aplikojnë për licencë në KPM.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për shërbime mediale audio-vizuele, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të

licencuarit e KPM-së. Kështu që, gjatë vitit 2013 kanë operuar gjithsej 21 TV Stacione, 83 Radio Stacione, 32 Operatorë Kabllorë dhe 53 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit kabllor.

Departamenti i Licencimit është përgjegjës edhe për të përcjellur pajtueshmërinë e të licencuarve lidhur me pagesën e taksës për licencë dhe këtë e ka realizuar edhe për vitin 2013 duke përcjellë shkresat në formë të njoftimit të subjekteve transmetuese, rreth afatit të pagesës së taksës për licencë, duke iu theksuar edhe shumën për pagesë.

Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës në vitin 2013

Subjekte transmetuese

21 TV stacione të licencuara:

- *1 TV stacion publik;*
- *14 TV stacione në gjuhën shqipe;*
- *5 TV stacione në gjuhën serbe;*
- *1 TV stacion në gjuhën turke.*

83 Radio stacione të licencuara:

- *2 radio stacione publike;*
- *45 radio stacione në gjuhën shqipe;*
- *25 radio stacione në gjuhën serbe;*
- *3 radio stacione në gjuhën boshnjake;*
- *2 radio stacione në gjuhën turke;*
- *2 radio stacione në gjuhën gorane;*
- *1 radio stacion në gjuhën rome;*
- *3 radio stacione multietnike.*

Operatorë Kabllorë:

32 operatorë kabllorë të licencuar

- *26 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë shqiptarë;*
- *2 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë goranë;*
- *4 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë serbë.*

Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP)

Gjithsej janë të licencuar 53 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit kabllor.

- *49 OSHP janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;*
- *1 OSHP është i licencuar të transmetojë program në gjuhën Serbe (OSHP TV Centar)*

- *3 OSHP janë të licencuar që transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art)*

Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2013, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 37 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHP-së, kërkesa për licencë të operatorëve kabllorë, kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesat për ndryshim të pronësisë si dhe kërkesa që kanë të bëjnë me kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës së KPM-së.

D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2013, me vendim të Komisionit, janë licencuar:

- 2 (dy) OSHP-ve në kuadër të RTK-së(RTK-3 NEËS dhe RTK-4 ART);
- 5 (pesë) OSHP-ve për operim në (1. 1ST CHANNEL - me seli në Prishtinë; 2. MBTV - me seli në Prishtinë; 3. TV DIASPORA - me seli në Pejë; 4. A9 INTERNATIONAL TV - me seli në Prishtinë; 5. CLICK CHANNEL - me seli në Fushë Kosovë);
- 19 operatorë kabllorë: **1. INTERSAT** - operon në komunën e Drenasit (me pronar shqiptarë); **2. ELKTRONI SHPK**- operon në Zhur (me pronar shqiptarë); **3 BB HERC** - operon në Shtërpç, Shilovë (Gjilan) dhe Pasjan (me pronar serbë); **4. GALAKTIKA**-operon në disa fshatra të komunës së Prizrenit (me pronar shqiptarë); **5. EGC** - operon në disa fshatra të komunës së Prizrenit (me pronar shqiptarë); **6. INTERNET ALBI@NET** - operon në fshatra te komunës së Malishevës dhe Klinës (me pronar shqiptarë); **7. CONNECT 3** - operon në disa fshatra të komunës së Malishevës (me pronar shqiptarë); **8. CONNECT-ISP** - operon në disa fshatra të komunës së Dragashit (me pronar shqiptarë); **9. ORANGE NET** - operon në disa fshatra të komunës së Kamenicës ,Gjilanit dhe Vitisë (me pronar shqiptarë); **10. NTSH BLEDI** - operon në disa fshatra të komunës së Malishevës(me pronar shqiptarë); **11. A-NET** - operon në Dobërçan komuna e Gjilanit (me pronar shqiptarë); **12. ISP BROADCAST** - operon në disa fshatra të komunës së Malishevës (me pronar shqiptarë); **13. HIGH SPEED SHPK** - operonë në disa fshatra të komunës së Podujevës (me pronar shqiptarë); **14. KOSOVA NET** - operon në komunën e Kamenicës (me pronar shqiptarë); **15. NEGENET SHPK** -operon në disa fshatra të komunës së Ferizajt (me pronar shqiptarë); **16. ARTMOTION** - operon në: Rahovec,Istog, Lipjan,Viti, Shtimje, Podujevë dhe disa fshatra të komunës së Ferizajt (me pronar shqiptarë); **17. VISION TV** - operon në disa fshatra të komunës së Podujevës (me pronar shqiptarë); **18. ASTRANET** - operon në disa fshatrat të komunës së Kaçanikut dhe Shtërpçës (me pronar shqiptarë); **19. ISP DIONI NET** operon në disa fshatra të komunës së Rahovecit (me pronar shqiptarë).
- Janë ndryshuar emrat e 3 të licencuarve (Radio Kosova në Radio Kosova 1, Radio Blue Sky në Radio Kosova 2 dhe OSHP Star Movies në OSHP K-Shqip), është ndryshuar pronësia e Radio HIT Laser dhe RTV Mir si dhe është lejuar ndryshimi i lokacionit të

sistemit të transmetimit për 5 (pesë) subjekte të licencuara (1. Radio Kosova e Lirë; 2. Radio HIT Laser; 3. Radio Shqip FM; 4. Radio Vizion dhe 5. Radio Mitrovica).

- Me kërkesë të të licencuarit për heqje dorë nga licenca, është revokuar licenca e OSHP 3TV.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013 ka shqyrtuar raste të ndryshme të shërbyesve medial audio-vizual për shkelje të dispozitave të Ligjit 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër shërbyesve medial audio-vizual, operatorëve kabllorë dhe ofruesve të shërbimeve programore.

Rastet e procedura në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit të KPM-së, Ligjit për Zgjedhjet dhe akteve nënligjore të KPM-së janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

Rastet për transmetim ilegal

Gjatë vitit 2013, janë proceduar njëzetetë (24) raste për shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon KPM-ja”*, dhe neni 30.5 i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa”*.

Rastet e proceduara për shkeljen e dispozitës së lartpërmendur janë paraqitur në tabelën 1 të shtojcës V të këtij raporti dhe kanë të bëjnë me njëzet e tre (23) operatorë kabllorë si dhe një (1) subjekt transmetues, të cilët kanë operuar pa licencë të KPM-së në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Departamenti Ligjor i KPM-së u ka dërguar Urdhëra këtyre operatorëve për ndërprerje të transmetimit ilegal. Te gjithë operatorët ilegalë të cilët edhe përkundër Urdhërit nuk e kanë ndërprerë transmetimin ilegal, KPM në asistencë me Policisë së Kosovës ka bërë edhe konfiskimin e pajisjeve të transmetimit konform me nenit 30.5 të ligjit të KPM-së. Pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve rastet janë mbyllur.

Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KKPM 2009/04;

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013, ka proceduar pesëmbëdhjetë (15) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale KKPM 2009/04. Shërbyesit Medial Audio-vizual janë gjetur në shkelje të nenit 7.1, 13.1, 13.6, 15.3 16.3, 17.2, 17.4 18.1, dhe 19.4 të Rregullores KKPM 2009/04. Shërbyesit Medial Audio-Vizual janë gjetur në shkelje për shkak të tejkalimit të minutazhes se lejuar të reklamimit dhe rregullave tjera të përgjithshme të komunikimeve komerciale audio-vizuale

Të gjitha rastet pas Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me Shkrim, kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2009/04. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013, ka proceduar tetë (8) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen e nenit 3.3, 6.1, 6.1.3, 6.2, 6.2.3, 7.3, 7.3.1, 4, dhe 7.1 të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio - Vizuele KPM 2013/01. Shërbyesit Mediale Audio-Vizual janë gjetur në shkelje të neneve të lartpërmendura si rezultat i transmetimit të programeve me përmbajtjeve të dëmshme programore jashtë kohës së përcaktuar me Rregullores KPM-2013/01.

Pas dërgimit të Shkresave dhe Njoftimeve për Shkelje të gjitha këto subjekte kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkelje të Rregullores për të Drejtën e Autorit

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013, ka proceduar dy (2) raste për shkelje të së drejtës autoriale. Shërbyesit Mediale Audio-Vizual kanë bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, dhe 2, të Rregullores për të Drejtën e Autorit.

Shërbyesit Mediale janë gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2013/02 si rezultat i transmetimit të programeve pa marrëveshje valide mbi të drejtën e autorit.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje këto subjekte kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës

Pjesa 3 e Licencës (Formati i Programit)

Gjatë vitit 2013, Departamenti Ligjor ka proceduar shtatë (7) raste për shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Pjesa e tretë (3). Shërbyesit Mediale janë gjetur në shkelje për shkak të ndryshimit të formatit të programit pa paralajmërim të KPM-së. Pas dërgimit të Shkresave dhe Njoftimeve për Shkelje, të gjitha këto subjekte kanë ardhur në pajtueshmëri me Pjesën 3 të Licencës. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01

(Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013 ka proceduar tetëdhjetetë (83) raste lidhur me shkeljet e Nenit 6.1 të Rregullores KKPM 2010/01, për mospagesë të taksës për licencë dhe mospagesë të kamatës së taksës për licencë. Departamenti Ligjor për të gjitha këto raste ka dërguar Njoftime për Shkelje, dhe Vërejtje me shkrim. Nga 83 subjekte, 58 prej tyre nuk kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2010/01. Këto raste barten në vitin 2014 dhe do të procedohen në Gjykatën Themelore për përmbarim.

Rastet e Shkeljes së Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM 2010/01.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013 ka proceduar dymbëdhjetë (12) raste lidhur me shkeljen e Nenit 1.4, 2.1, 2.2, 4.1, 6.2 dhe 7.1, të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01. Shërbyesit Medial janë gjetur në shkelje të këtyre neneve si rezultat i transmetimit të programeve jo të balancuara, mos verifikimit të fakteve gjatë transmetimit të programeve dhe shkeljes së privatësisë.

- Pas dërgimit të shkresave nga ana e Departamentit Ligjor për shkelje të nenit 7, paragrafi 1, subjektet transmetuese RTV 21 dhe KTV, kanë ardhur në pajtueshmëri me Kodin e Sjelljes KKPM 2010/01. Ndërsa, ofruesi i shërbimeve programore Klan Kosova ka bërë shkelje të nenit 1.4, 2.1, 2.2, 4.1, 6.1, 6.2, 7.1, i cili pas pranimin të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtje me shkrim, ka ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.
- Ndërsa, pas dërgimit të Vërejtjeve nga ana e Departamentit Ligjor për shkelje të nenit 9, paragrafi 8, shtatë (7) subjekte transmetuese, kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.
- Po ashtu, edhe subjekti transmetues TV Syri Vision dhe ofruesi i shërbimeve programore Klan Kosova ka bërë shkelje të nenit 9.8. Komisioni i KPM-së mori Vendim për shkeljet e bëra. Masa sanksionuese e Vendimit të Komisionit ka qenë *Vërejtje*. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, neni 2.1.3, dhe 2.1.5 dhe nenit 18.3 dhe nenit 18.4, të Rregullores për Distribucionin e Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013 ka proceduar nëntë (9) raste lidhur me këtë shkelje:

- Operatori Kabllor Kujtesa Net ka bërë shkelje të nenit 2.1.3, dhe 2.1.5. Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, operatori kabllor ka ardhur në pajtueshmëri dhe rasti është mbyllur.
- Ndërsa tetë (8) operatorë kabllorë kanë bërë shkelje të nenit 18.3 dhe nenit 18.4, dhe pas dërgimit të Njoftimit, kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur.

Shërbyesit Medial janë gjetur në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe Rregullores CIMC 2007/04, si rezultat i transmetimit të programeve pa marrëveshje valide mbi të drejtën e autorit.

Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së neni 28 – Mos sjellja e raportit vjetor

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013, ka proceduar pesëdhjetenëntë (59) raste lidhur me këtë shkelje:

- Nga këto 59 raste, 16 prej tyre, pas dërgimit të Vërejtjes me shkrim nga Departamenti Ligjor, kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.

- Ndërsa, për 28 subjekte dhe ofruese të shërbimeve programore të cilat nuk kanë ardhur në pajtueshmëri, duke mos e sjellë raportin vjetori, Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim që këtyre subjekteve t'i shqiptojë Vërejtje.
- Nga të gjitha subjektet transmetuese, 15 prej tyre Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim sanksionues me gjobë në shumën prej 1.000,00 euro (një mijë), pasi që të njëjtat edhe viteve të kaluara kanë bërë shkeljen e njëjtë.

Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së, Neni 22 paragrafi 3.1

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013, ka proceduar katër (4) rast lidhur me këtë shkelje:

- Subjektet transmetuese Radio Premiera, Radio Gora dhe Radio Kompas kanë bërë shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1. Departamenti Ligjor iu ka dërguar Vërejtje me shkrim. Subjektet Transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur.
- Gjithashtu në shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1, është gjetur edhe subjekti transmetues TV MIR, i cili edhe pas dërgimit të Vërejtjes me shkrim nga Departamenti Ligjor, ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. Komisioni i KPM-së mori Vendim sanksionues me Vërejtje. Rasti është mbyllur.
- Shërbyesit Medial të lartpërmendur janë gjetur në shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së, si rezultat i përfshirjes së pronareve të tyre në aktivitete politike.

Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 49, paragrafi 7, dhe Neni 48

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2013 ka proceduar gjashtëdhjetë (60) raste lidhur me shkeljen e nenit 48 dhe 49, paragrafi 7:

- Nga këto raste pesëdhjetëtetë (58) subjekte transmetuese kanë bërë shkelje të nenit 49, paragrafi 7, të cilat pas dërgimit të Vërejtjes me shkrim nga Departamenti Ligjor, kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.
- Ndërsa në shkelje të nenit 48 janë gjetur subjektit transmetues TV Syri Vision dhe ofruesi i shërbimeve programore Klan Kosova. Edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes dhe Urdhrit, Syri Vision dhe Klan Kosova kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me nenin 48. Komisioni i KPM-së mori Vendim sanksionues me Vërejtje. Rastet janë mbyllur.
- Shërbyesit Medial të lartpërmendur janë gjetur në shkelje të nenit 48 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si rezultat i përfaqësimit jo të barabartë të subjekteve politike në emisionet e shërbyesve medial audio-vizua gjatë fushatës së zgjedhjeve, si dhe nenit 49, paragrafi 7, mos sjellja e ditarëve në KPM në lidhje me kohën e siguruar pa pagesë për subjektet politike dhe reklamimin e ofruar me pagesë për çdo subjekt politik të certifikuar.

Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2013

Janë proceduar katër (4) raste:

- Rasti i parë është proceduar bazuar në ankesën e Kafiterisë Creme de la Creme ndaj Radio Urban FM, në ankesë thuhet se Radio Urban FM ka bërë shpifje në lidhje me kafiterinë Creme de la Creme. KPM lidhur me këtë rast i ka dërguar Njoftim për Shkelje dhe Vërejtje Radio Urban FM për shkelje të nenit 2, paragrafi 1, dhe 2, dhe nenit 4, paragrafi 4.4, të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01. Subjekti transmetues Radio Urban FM ka dështuar të veprojë në pajtim me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale.
- Rasti dytë, është proceduar bazuar në ankesën e Savez Kosovski Srba ndaj Radio Gracanica, ku në ankesë thuhet se Radio Gracanica gjatë raportimit të fushatës zgjedhore ka favorizuar Iniciativën Qytetare Srbska. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e Radio Gracanica, dhe ka gjetur se Radio Gracanica nuk ka bërë shkelje. Departamenti Ligjor i ka dërguar Shkresë Savez Kosovski Srba përmes të cilës e ka njoftuar se ankesa e tyre është e pa bazuar. Rasti është mbyllur.
- Rasti i tretë është proceduar bazuar në ankesën e Berat Preniçit ndaj RTV 21, ku në ankesë thuhet se RTV 21 ka transmetuar një reklamë me përmbajtje të dëmshme programore, dhe se ka bërë shkelje të nenit 2 pika 6 të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore KPM 2013 /01. KPM ka bërë shqyrtimin e ankesës së B. Preniçi dhe ka bërë monitorimin e RTV 21. KPM gjatë monitorimit ka vërejtur se RTV 21 nuk ka bërë shkelje të Rregullores KPM 2013 /01. Departamenti Ligjor i ka dërguar Shkresë B. Preniçi për t'u vërtetuar se ankesa ka qenë e pa bazuar. Rasti është mbyllur.
- Rasti i katërt është proceduar bazuar në ankesën e partisë Bashkimi Demokratik ndaj RTK, ku në ankesë thuhet se RTK nuk e ka mbuluar e fushatën zgjedhore të partisë Bashkimi Demokratik. KPM ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe ka bërë monitorimin e RTK. KPM gjatë monitorimit ka vërejtur se RTK nuk ka bërë shkelje. Departamenti Ligjor i ka dërguar shkresë partisë Bashkim Demokratik për t'u vërtetuar se ankesa e tyre ka qenë e pa bazuar. Rasti është mbyllur. (*Shtojca III Tabela e Rasteve Ligjore*)

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge

Gjatë vitit 2013, janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së tyre me përcaktimet që u janë bërë për zonën e mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës. Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio televizive që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2012, me

përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë (65 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e pa ndërferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht, territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm me 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimi i rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive. Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar, ashtu që të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)

Gjatë vitit 2013 Departamentit për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2013, të cilat kanë patur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale), me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 Mhz).

Sipas matjeve të kryera , janë identifikuar këto zona me segmente të caktuara rrugore me relief kodrinor ku niveli i pranimit të sinjalit është shumë i dobët ose nuk ka fare pranim , që nevojitet të mbulohen me frekuenca shtesë si në vijim:

- Kaçanik – Hani i Elezit 2 frekuenca;
- Mitrovicë – Bajgorë 1 frekuencë;
- Shtime – Caralevë 1 frekuencë;
- Dragash – Restelicë 1 frekuencë;
- Prizren – Brezovicë 1 frekuencë;
- Rugovë 1 frekuencë;

- Kramovik – Dollc 1 frekuencë;
- Badovcë-Slivovë, Bresalcë 1 frekuencë;
- Kamenicë- qytet 1 frekuencë;

KPM mund të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave të lartpërmendura.

Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e painterferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës.

Televizionet regjionale – lokale mbulojnë rreth 68.14% të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth 96.98% të territorit të Kosovës.

Rastet për interferencë

Gjatë vitit 2013 DMF, ka pranuar vetëm dy ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese. Raportet e detajuara lidhur me këto dy ankesa rezultojnë se në asnjërin rast nuk ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues:

- Radio Star (Gjilan), është konstatuar se ka pasur probleme me transmetuesin dhe nuk ka pasur interferime nga jashtë.
- Radio Dukagjini është ankuar për interferim të vazhdueshëm në frekuencë pune 105.1 MHz për regjionin e Mitrovicës nga një radio që transmeton programin në gjuhën serbe . Radio Dukagjini, gjithashtu ka pohuar që frekuenca e radio Dukagjinit për Mitrovicë punon me fuqi të vogël (20 Ë) dhe nuk arrin të dëgjohet as në qytet. Pas matjeve është konstatuar që radio Dukagjini nuk është i interferuar por ka pasur probleme me sistemin e transmetimit respektivisht me zvogëlimin e fuqisë së transmetimit në 20 Ë shkak të problemeve që ka pasur në transmetues.

Rastet për transmetime të palicencuara

DMF gjatë vitit 2013 ka proceduar vetëm me një rast të një radio ilegale me emrin Radio 038 , që transmeton program në frekuencë 87.7 MHz në komunë të Graçanicës. Edhe pas intervenimit të KPM-së dhe njoftimit të KPM-së për statusin e subjekteve ilegale dhe masave të mundshme që mund të merren ndaj tyre, transmetimi ende nuk është ndërprerë.

Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR.

DMF gjatë vitit 2013 ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio dhe televizive që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja.

Gjate vitit 2013, radio e huaj ndërkombëtare DË ka ndërprerë transmetimin e vet, ndërsa radiot të tjera BBC, VOA dhe RFI vazhdojnë transmetimet e tyre.

Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare , nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës.

Gjatë vitit 2013 në takimet me KFOR është bërë azhurnimi i bazës së të dhënave të frekuencave që janë në shfrytëzim të KFOR-it , me c`rast KFOR-i ka liruar një numër të caktuar frekuencash radio dhe janë kthyer në menaxhim të KPM-së . Po ashtu, ka liruar të gjitha frekuencat televizive që ka shfrytëzuar për nevojat e tyre, dhe tani janë në menaxhim të KPM-së.

Ka vazhduar bashkëpunimi i KPM me KFOR për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Buxheti

Komisioni i Pavarur i Mediave është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Për vitin 2013, KPM-së i është ndarë buxhet prej 834,863 Euro duke përfshirë të hyrat vetanake të bartura nga viti 2012 në shumën prej 45,324 Euro dhe investimin kapital prej 10,000 Euro.

Për periudhën Janar dhjetor 2013, Komisioni i Pavarur i Mediave ka shpenzuar buxhetin në vlerë prej 752,987 euro apo 90 %.

Buxheti i Komisionit të Pavarur i Mediave për vitin 2013				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe mëditjet	373,769	373,769	296,475	77,294
Mallra dhe Shërbime	395,770	385,770	384,774	997
Shërbime Komunale	20,000	20,000	17,086	2,914
Shpenzimet Kapitale		10,000	9,329	671
Të Hyrat e bartura 2012		45,324	45,323	1
Total:	789,539	834,863	752,987	81,876

Nga të hyrat vetanake të mbledhura prej taksës së licencës nga shërbimet audio-vizuale janë gjeneruar 401,972 Euro, prej tyre 312,501 euro u takojnë të hyrave nga licenca ndërsa shumat prej 15,225 euro dhe 74,247 euro u takojnë kamatave për vonesa dhe gjambat. Mjetet nga të hyrat shkojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2012 në vlerë prej 45,324 janë shpenzuar edhe për vazhdimin e strategjisë për kalimin nga sistemi analog i transmetimit në sistemin digjital të Republikës së Kosovës.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti fillestar në vlerë prej 395,770 euro është zbritur në vlerë prej 10,000 euro për projektin kapital të aprovuar. Projekti i ri: Antena për

Pajisjen (veturën) Mobile të Monitorimit, është realizuar pas kërkesës për rishikim të buxhetit 2013 në Departamentin e Buxhetit.

Në Shtojcën 1 është dhënë Raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Ministrinë e Financave dhe në Zyrën e Auditorit Gjeneral. (*Shtojca IV Raporti Financiar i dhënë sipas kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës*)

BORDI I ANKESAVE

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, bazuar në nenin 38 pika 2.1. i cili përcakton “*brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Bordit apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, Kuvendi i Kosovës në pajtim me Rregulloren e punës nxjerrë shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj*”,

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit të KPM-së. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me vendimet e Komisionit të KPM-së.

Seancat e Bordit të Ankesave dhe Vendimet

Bordi për Ankesa (BA) gjatë vitit 2013, ka shqyrtuar gjithsej 4 ankesa dhe 2 kërkesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së.

Rastet të cilat janë shqyrtuar nga ana e Bordit për Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së gjatë vitit 2013 janë si në vijim:

1. Ankesa e subjektit transmetues RTV 21. Bordi për Ankesa, me datën 7 maj 2013, ka shqyrtuar ankesën e RTV 21 kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 15.000.00 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, për shkelje të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KKPM-2009/04. Pas shqyrtimit të ankesës së RTV 21, Bordi për Ankesa e ndryshoi lartësinë e gjobës që është përcaktuar me vendim të Komisionit të KPM-së, duke e zbritur nga 15.000.00 (pesëmbëdhjetë mijë) euro në 10.000.00 (dhjetë mijë) euro.
2. Ankesa e operatorit Kabllor EAGLE. Bordi për Ankesa me datën 8 maj 2013, ka shqyrtuar ankesën e Operatorit Kabllor Eagle kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 45.000.00 (dyzetepesë mijë) euro, për shkelje të Kushteve dhe Termeve të përgjithshme të Licencës. Pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Kabllor Eagle, Bordi për Ankesa e ndryshoi lartësinë e gjobës që është përcaktuar me vendim të Komisionit të KPM-së, duke e zbritur nga 45. 000.00 (dyzetepesë mijë) euro, në 35.000.00 (tridhjetepesë mijë) euro.
3. Ankesa e operatorit Kabllor IPKO. Bordi për Ankesa me datën 8 maj 2013, ka shqyrtuar ankesën e Operatori Kabllor IPKO kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 60.000.00 (gjashtëdhjetë mijë) euro për shkelje të Ligjit të KPM-së. Pas shqyrtimit të Ankesës së Operatorit kabllor IPKO, Bordi për Ankesa ka vërtetuar Vendimin e Komisionit të KPM-së dhe në bazë të Vendimit

- përfundimtar, IPKO obligohet të paguajë gjobën në vlerë prej 60.000.00 (gjashtëdhjetë mijë) euro.
4. Ankesa e subjekti transmetues Radio Kolashin. Bordi për Ankesa me datën 25 nëntor 2013, ka shqyrtuar ankesën e Radio Kolashin kundër gjobës së shqiptuar me vendim të Komisionit të KPM-së në vlerë prej 1.000,00 (një mijë) euro për mos sjellje të raportit vjetor financiar për vitin 2012. Bordi për Ankesa pas shqyrtimit të Ankesës së Radio Kolashin, ka vërtetuar Vendimet e Komisionit të KPM-së dhe në bazë të Vendimit përfundimtar, Radio Kolashin obligohet të paguajë gjobë në vlerë prej 1.000,00 (një mijë) euro.
 5. Kërkesa e subjektit transmetues RTV 21. Bordi për Ankesa me datën 16 gusht 2013, ka shqyrtuar kërkesën RTV 21 për mundësimin e pagesës së gjobës në shumë prej 10.000.00 (dhjetë mijë) euro me këste. Bordi për Ankesa ka aprovuar kërkesën e RTV 21 dhe ka vendosur që pagesa e gjobës në shumë prej 10.000.00 (dhjetë mijë) euro, të bëhet në dhjetë 10 këste, në periudhë brenda 10 muajve, duke filluar nga muaji shtator i vitit 2013, deri në muajin qershor të vitit 2014.
 6. Kërkesa e Radio Televizionit të Kosovës RTK 1. Bordi për Ankesa, po ashtu me datën 11 dhjetor 2013, ka shqyrtuar kërkesën e RTK 1 për mundësimin e pagesës së gjobës në shumë prej 105.00 (njëqindpesë mijë) euro me këste. BA ka aprovuar kërkesën e RTK 1 dhe ka vendosur që gjobën në shumë prej 105.000 (njëqindpesë mijë) euro, t'i mundësojë ta paguajë në këste në periudhë brenda 36 muajve, duke filluar nga muaji janar i vitit 2014 deri në dhjetor të vitit 2016.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE PËR VITIN 2013

ZHVILLIMI I POLITIKËS SË TRANSMETIMIT

Në maj të vitit 2013 janë miratuar aktet nënligjore të cilat janë amandamentuar në pajtim me Ligjin e ri të KPM-së dhe Direktivën për Shërbimet Mediale AudioVizuale (AVMS):

- Rregullorja për Komunikime Komerciale Audio-vizuele
- Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuele
- Rregullorja për të Drejtën e Autorit
- Rregullorja e KPM-së për Dhënien e Licencës
- Pjesa 1- Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së

Edhe pse është caktuar prioritet parësor finalizimi i ndryshimit të të gjitha akteve nënligjore të KPM-së me ndryshimin e

- a) Rregullores për operatorët kabllorë,
- b) Kodit të sjelljes; dhe
- c) Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës

Për shkak të zhvillimeve që kanë përcjellur Komisionin me përbërje, kjo objektivë është realizuar vetëm pjesërisht. Është filluar procesi i konsultimit publik mirëpo nuk është arritur të procedohet më fazën e vlerësimit të komenteve dhe inkorporimit të ndryshimeve para miratimit nga Komisioni.

PËRCJELLJA E PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT NË TËRË KOMPLEKSITETIN E VET

- a) Fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore të KPM-së

Nuk janë lejuar shtim i stafit dhe nuk janë ndarë në tërësi mjetet e kërkuara për të realizuar fuqizimin e kapaciteteve teknike brenda një viti. Kjo objektivë vazhdon në vitet 2014 dhe 2015 përmes projektit për avancimin e pajisjeve softwerike dhe hardwerike të KPM-së për planifikim dhe implementin të sistemit digjital në Kosovë (të brezit frekuencor digjital tokësor).

- b) Krijimi i kushteve për punë të stafit dhe anëtarëve të KPM-së-ndërtimi i objektit të KPM-së.

Nuk është realizuar në mungesë të mjeteve dhe hapësirës së caktuar të nevojshme për ndërtim.

- c) Krijimi i politikave për procesin e digjitalizimit;

Draft strategjia nuk është dërguar në Qeveri në 2013. Kjo mbetet të bëhet në 2014 dhe të fillohet edhe me zbatimin e planit të veprimit.

- d) Koordinimi me shtetet fqinjë i planit frekuencor digjital (me qëllim që të mos ketë interferime në brezin frekuencor);

Mbetet të vazhdohet në vitin 2014 por gjithçka mbetet në varësi të procesit të zhvillimit të dialogut për zbatimin e marrëveshjes me Serbinë (për Telekomin në kuadër të të cilës hyn edhe koordinimi i frekuencave digjitale).

Sidoqoftë, në kuadër të kësaj objektive është punuar vetëm në Ndryshim/plotësimin e Draft Strategjisë për kalim në transmetimin digjital në Republikën e Kosovës

Strategjia për kalim nga transmetimi analog në transmetimin digjital në Republikën e Kosovës, e cila është dërguar fillimisht në Qeveri në dhjetor 2012, i është kthyer KPM-së për plotësim-ndryshim. Pas rekomandimit të Zyrës për Planifikim Strategjik të Kryeministrit të Republikës së Kosovës për plotësimin e pjesës teknike dhe hartimin e planit të veprimit së bashku me koston financiare të Draft Strategjisë, KPM-ja ka marrë të gjithë hapat e duhur për përfundimin e Draft Strategjisë.

Në mbledhjen e mbajtur me 23 maj 2013, KPM ka krijuar një grup të veçantë i cili ka bërë një analizë të pjesëve të strategjisë sipas kërkesës së Qeverisë së Kosovës. Plotësimet në draft janë bërë nga grupet punuese të krijuara më parë nga KPM. Draftin e ndryshuar KPM e ka vënë në konsultim publik nga data 22 korrik 2013 deri më 9 gusht 2013, për 15 ditë pune sipas procedurës ligjore. Pas konsultimit publik, KPM ka analizuar komentet publike dhe gjatë muajit shtator ka punuar edhe me ekspertin e angazhuar përmes Komisionit Evropian për të bërë ndryshimet dhe plotësimet finale. Mirëpo, për shkak të zhvillimeve në KPM të cilat në fund të vitit rezultuan edhe me shkarkimin e kryetarit të KPM-së dhe një anëtareje, KPM nuk arriti të përfundojë strategjinë dhe ta dërgojë në Qeveri (gjë e cila do të duhej bërë edhe pas një konsultimi publik për 15 ditë pune).

Gjithashtu në lidhje me këtë proces duhet përmendur se KPM -ja është angazhuar edhe në Grupin Punues për hartimin e Ligjit për Digjitalizim, të iniciuar dhe udhëhequr nga Ministria për Zhvillim Ekonomik (MZHE), ku KPM i ka drejtuar të gjitha vërejtjet e bazuara dhe të argumentuara sponsoruesit të këtij ligji- Ministrisë për Zhvillim Ekonomik.

ZHVILLIMI I PLURALIZMIT MEDIAL QË U SHËRBEN GJITHË QYTETARËVE TË KOSOVËS

- a) Lëshimi i licencave të reja – vendimi i KPM-së për frekuencat lokale

Në fillim të vitit 2013 Komisioni ka marrë vendim për licencime të reja (13 frekuenca radio televizive) dhe ka hartuar edhe rregulloren për vlerësim të aplikacioneve për konsultim publik. Çështja e miratimit të rregullores dhe vazhdimi i procesit me licencime të reja, para procesit të digjitalizimit, mbetin për t'u adresuar gjatë vitit 2014 nga Komisioni me përbërje të re.

MBULUESHMËRIA E ZONAVE TË VEÇANTA GJEOGRAFIKE TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (rrugëve magjistrale dhe regjionale) ME SINJAL KUALITATIV TË PROGRAMEVE TE RADIO PROGRAMEVE ME MBULUESHMËRI NACIONAL

Për realizim të kësaj objekte janë bërë matjet për të vlerësuar nivelin e sinjalit të mbulueshmërisë dhe për të rekomanduar veprimet e nevojshme edhe nga ana e KPM_së edhe nga ana e të licencuarve. Vlerësimet dhe analizat teknike kanë rezultuar me identifikim të zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës, në rrugët magjistrale dhe regjionale, me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 Mhz).

Sipas matjeve të kryera , janë identifikuar këto zona me segmente te caktuara rrugore me relief kodrinor ku niveli i pranimit të sinjalit është shumë i dobët ose nuk ka fare pranim prandaj gjatë vitit 2014 duhet të sigurohen frekuenca shtesë dhe intervenime në sistemin e transmetimit të subjekteve transmetuese për të realizuar mbulueshmërinë me radio programe në nivel nacional.

KRIJIMI I KUSHTEVE PËR ARKIVIMIN AFATGJATË TË PROGRAMEVE TË MONITORUARA (afati ligjor 7 vite)

Me buxhetin e alokuar për vitin 2014 janë ndarë mjete për të filluar projektin e krijimit të arkivës digjitale afatgjate. Projekti është i planifikuar në tri faza dhe faza e parë do të implementohet në vitin 2014.

AVANSIMI I BASHKËPUNIMIT ME AUTORITETET RREGULLATIVE EVROPIANE:

- b) Angazhimi i KPM-së - Koordinimi me institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, për pranimin e KPM-së në të gjitha institucionet ndërkombëtare, që lidhen me fushën e rregullimit të transmetimit dhe brezit frekuencor radiodifuziv.

Proces në vazhdimësi.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014

Në vitin 2014 do të vazhdojë realizimi i objektivave nga viti 2013:

- Finalizimi i strategjisë për digjitalizim; dhe
- Finalizimi i të gjitha procedurave për ndryshimin e akteve nënligjore për transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audio dhe audio-vizuale në operatorët e rrjeteve (ndryshimi i rregullores për operatorët kabllorë), dhe rregullorja për nivelin dhe pagesën e taksës për licencë.